



VISIT-TIRANA.com
...a colorful feeling



GAZETA MUJORE E TIRANËS, QERSHOR 2017

Art, kulturë, muzikë, argëtim, aventurë e plot surpriza, për ata që e duan këtë qytet

Sheshi Skenderbej, atraksioni i muajit



Sheshi Skënderbej u rihap më 10 Qershor, në një atmosferë fantastike që kishte vite që nuk ishte parë në Tiranë. Edhe pse i kontestuar nga disa grupime, Sheshi Skënderbej ka qenë padiskutim vendi më i vizituar këtë muaj nga qytetarët shqiptarë dhe turistët. Hapesira e madhe, shatërvanet, godinat historike përreth janë bërë objekte fotografimi nga të gjithë.

[Më tepër](#)

Rekomandimet për turistët në Qershor



Qershori është muaji ku mbyllet dhe viti shkollor dhe në këtë kohë parqet janë të mbushura me fëmijë që luajnë deri pasdite vonë. Baret janë të hapura deri në orët e vona të mbrëmjes, Tirana gjallërohet dhe ka aktivitete të shumta. Ne sugjerojmë disa gjëra për t'u bërë në Qershor nga ata që vizitojnë Tiranën

[Më tepër](#)

Një bulevard i ri drejt Tiranës moderne



Segmenti i parë i Bulevardit të Ri të Tiranës u inaugurua në 20 Qershor. Bulevardi i Ri nis që nga ish-Stacioni i Trenit në Tiranë, në fund të Bulevardit Zogu i parë, do të jetë 1.6 km kur të përfundojë. Ndoshta është nga bulevardët e parë ku janë respektuar gjithë standardet e hapësirave të gjelbra, rrugës për këmbësorë e korsi bicikletash. Dritat janë ekologjike me teknologjinë më të fundit.

[Më tepër](#)

Televizioni Serb TV1- Tirana, qyteti i të rinjve dhe jetës së natës



Shumë serbë kanë vizituar Tiranën këtë vit. Ata e pëlqejnë kryeqytetin tonë dhe e konsiderojnë si një qytet modern me rini dhe njerëz shumë miqësor. E shkuara dhe politika nuk i pengon shqiptarët të shijojnë jetën e të mirëpresin çdo turist. Ky ishte mesazhi i reportazhit serb për Tiranën.

[Më tepër](#)

Tirana ka tani parkun e saj Olimpik



Tirana ka tashmë Parkun e ri Olimpik, i cili u inaugurua më 4 qershor 2017. Në mënyrë simbolike në këtë ceremoni u zhvillua një ndeshje miqësore basketbolli mes ish lojtarëve të ekipeve kombëtare nga Shqipëria dhe Kosova. Së shpejti një tjetër projekt madhor sportiv pritet të përfundojë dhe ky është stadiumi modern 'Qemal Stafa' i cili do të jetë sipas gjithë standardeve bashkëkohore.

[Më tepër](#)

Kthimi i bunkerëve në qendra artistike nga një projekt rinor



Shqiptarët janë njerëz optimistë, edhe pse vijnë nga një e kaluar e errët si periudha e komunizmit. Bunkerët të shpërndarë në gjithë vendin na kujtojnë ende ato vite të errëta. Por një ekip të rinjsh po zhvillojnë një projekt për t'i llyer, zbukuruar dhe për t'i kthyer bunkerët në qendra kulturore.

[Më tepër](#)

Eventet e muajit Qershor, Tirane

- Shend e Verë (1 Qershor), aktivitete për fëmijë në Parkun e Madh
- Mbrëmja e parë përkujtimore mbi Falcon në Shqipëri (2 Qershor)
- Ekspozita “Tjetërsim” në GKA” (2-23 Qershor)

[Më tepër](#)

Eventet e muajit Korrik në Tiranë

- Koncert me Muzike Dhome “Albanian Brass”, në qendren e qytetit me 2/07/2017
- Gumball 3000, rikthehet në Shqipëri, data 05/07/2017
- Plazh n’bllok, me 8 korrik, ora 12.00-23.00 me Ad Disha, Dj Sardi, Dj Aldo

[Më tepër](#)



Reklamoni në portalin tonë!

Kontaktoni në: Tel: +355 4 5800419 ose Email: contact@visit-tirana.com

Botim i Manderina Promotions, kompani PR dhe Marketing në Tiranë. Për shërbimet tona kliko : www.manderina.com

Ju mund [te ndryshoni preferencat tuaja](#) or [ç'regjistroheni nga kjo list](#).